

V E N D I M
Nr. 241, datë 20.4.2001

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“TRI URAT-ÇARSHOVË”, NË TERRITORIN E QARKUT TË PËRMETIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 554, datë 16.8.2006)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5, të neneve 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, të pronave, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tri Urat Çarshovë”, në territorin e qarkut të Përmetit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe të përgjithshme 3 296 m², vlerësuar në shumën e përgjithshme 2 352 700 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind) lekësh.

3/1 Pronari i pasurisë së paluajtshme z.Jani Sotir Xhallo, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 373 m² tokë bujqësore, e vlerësuar me 700 lekë/m², e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh.

4. Fondi për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2001, në zërin “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit.

4/1 Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Shpenzimet procedurale, në shumën prej 112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve

5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.5.2001.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Listat e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit
rë segmentit rrugor Tre Urat - Çarshovë

RRETHI PËRMET / KOMUNA ÇARSHOVË Lloji i pasurisë së paluajtshme, tokë
bujqësore nr. (1-7)

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Nr.i aktit	Nr i parcelës	Sip./m2	Çmimi lek/m2	Totali në lek
1.	Thanas Vasil	3030	224/25	96	700	67200

	Drasa					
2.	Dhimitër Thanas Drasa	3021	224/27	87	700	60900
3.	Dhionis Vasil Kobuzi	3072	224/27	435	700	304500
4.	Apostol Llazo Drasa	3076	222/1	749	700	524300
5.	Ilia Apostol Drasa	3076	222/2	517	700	361900
6.	Pano Foti Bitika	3057	222/3	411	700	287700
7.	Ali Myrteza Myrtolli	3727	64/4	30	700	21000
	Shuma			2325		1.627.500

Lloji i pasurisë së paluajtshme, tokë bujqësore Nr.1

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Nr.i aktit	Nr i parcelës	Sip./m2	Çmimi lek/m2	Totali në lek
1.	Konflikt		222/4	971	700	679700
	Shuma			971		679700

MINISTRIA E TRANSPORTIT
Shpenzime publikimi 45 500 lekë

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I KANALIT TË UJËRAVE
TË BARDHA GJATË SEGMENTIT RRUGOR TRI URAT ÇARSHOVË
(shtuar me vkm nr. 554, datë 9.8.2006)

Nr.	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmini në lekë për m ²	Vlera në lekë
1.	Jani Sotir Xhallo	Nr.163/26	1356	373 m ²	700	261 100

Vlera totale e këtij shpronësimi është 261 100 (dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e njëqind lekë).